Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-360
Datë: 02.05.2025

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, nenin 108 të Ligjit mbi procedurën administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016), Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 02.05.2025 nxjerr këtë:

VENDIM

1. **Akreditohet dhe Validohet** German Gymnasium Sh.P.K, Lagjia Veternik, Rr. Gjilani, Nr.201, Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.09.2025 deri 31.08.2028, me kualifikimin e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

   1.1. **Teknologji e Informacionit,** Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara (C), me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e mësimit me tridhjetë (30) nxënës në një klasë, brenda vitit të parë shkollor mund t'i regjistroj deri në 2 klasa, me nga 30 nxënës që në total i bie 60 nxënës. Ndërsa, brenda vitit të dytë shkollor mund t'i regjistroj deri në 4 klasa, me nga 30 nxënës që në total i bie 120 nxënës, kurse në vitin tretë shkollor mund t'i regjistroj deri në 5 klasa, me nga 30 nxënës që në total i bie 150 nxënës, që në total i bie 330 nxënës për 3 vite të akreditimit.

2. Institucioni obligohet të plotësojnë kushtet bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues dhe kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit German Gymnasium Sh.P.K, të parashtruar në AKK kërkesë për akreditim dhe validim të institucionit për kualifikimin Teknologji e informacionit, Niveli III dhe IV i KKK, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushe veprimtaria e AKK-së ka caktuar ekipet e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për akreditim dhe validim për kualifikimet si më lartë.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit 06.03.2025 për kualifikimin Teknologji e informacionit, ndërsa vizita është realizuar me datat 07.03.2025. Pas përfundimit të procesit vlerësuese raportet janë realizuar me datë 22.04.2025. Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 02.05.2025.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacionet për validim të kualifikimeve, aplikacionet për akreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni si dhe të gjeturave me rastin e realizimit të vizitave së realizuar tek pala aplikuese.

AKK bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr/ 03/L-060 Për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë është e obliguar të realizoj procesin e monitorimit dhe të raportoj tek Këshilli Drejtues i AKK-së.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së në bazë të kërkesës së Institucionit German Gymnasium Sh.P.K, për akreditim dhe validim, si dhe rekomandimeve përfundimtare të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese për akreditim dhe validim për institucionin aplikues, të gjeturave në raportet vlerësuese, si dhe nga të lartcekurat vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

- German Gymnasium Sh.P.K;
- Arkivit të AKK.



Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK